



Modernizim Ajror, Rindërtim Detar dhe Prodhim 'Made in Albania': Forcat e Armatosura drejt një Epoke të Re Strategjike



» faqe 3



SHQIPËRIA, MIKE NDERI NË PARADËN USHTARAKE TË 30-VJETORIT TË DITËS SË FITORES DHE TË VETERANËVE NË KROACI

Zagreb, Kroaci – Me rastin e 30-vjetorit të Ditës së Fitores dhe të Veteranëve, një nga ngjarjet më të rëndësishme të kalendarit kombëtar kroat, Shqipëria mori pjesë si mike nderi në paradën ushtarake të organizuar në kryeqytetin kroat, Zagreb. Me ftesë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kroacisë, ceremoninë e përfaqësoi shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura...

» faqe 2



FORCAT E OPERACIONEVE SPECIALE MISIONI QË NUK SHEFAQET, POR QË VEPRON

Në një botë gjithnjë e më të paparashikueshme, siguria kombëtare nuk varet më vetëm nga numrat, por nga cilësia. Brenda strukturës së Forcave të Armatosura të Shqipërisë, ekziston një njësi që vepron në hije, me saktësi, vendosmëri dhe përgatitje maksimale: Forcat e Operacioneve Speciale, të njohura si ROS. Kjo njësi nuk është vetëm krenari kombëtare. Ajo është një standard profesionalizmi, i ndërtuar...

» faqe 6



NË KOHË PADREJTËSIE, QËNDRIMI ËSHTË AKT HEROIK

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nuk mjafton të jetosh, duhet të jetosh me kuptim. Vitet kalojnë, rrethanat ndryshojnë, por ajo që qëndron është ndikimi që kemi në vetvete dhe të tjerët. Jetesa nuk është thjesht një përpjekje për të kaluar ditët, por një mision për të gjetur ndriçimin, për të bërë dritë aty ku ka errësirë. Kjo është rruga drejt përmbushjes së qenies, që tejkalon të gjitha pengesat.

» faqe 7

Shqipëria, Mike Nderi në Paradën Ushtarake të 30-vjetorit të Ditës së Fitores dhe të Veteranëve në Kroaci



Zagreb, Kroaci – Me rastin e 30-vjetorit të Ditës së Fitores dhe të Veteranëve, një nga ngjarjet më të rëndësishme të kalendarit kombëtar kroat, Shqipëria mori pjesë si mike nderi në paradën ushtarake të organizuar në kryeqytetin kroat, Zagreb. Me ftesë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kroacisë, ceremoninë e përfaqësoi shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji. Pjesëmarrja shqiptare në këtë aktivitet të nivelit të lartë ishte një dëshmi e marrëdhënieve të ngushta dhe partneritetit strategjik midis Shqipërisë dhe Kroacisë.

Në paradë morën pjesë edhe flamurtarët shqiptarë, të cilët marshuan krah për krah me trupat kroate dhe aleate të tjera të NATO-s, duke dhënë një mesazh të qartë bashkëpunimi dhe solidariteti në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ky moment solemn shërben si një simbol i angazhimit të Shqipërisë për forcimin e partneriteteve rajonale, si dhe për promovimin e stabilitetit dhe sigurisë së përbashkët, në kuadër të aleancës së NATO-s dhe bashkëpunimit dypalësh ndërmjet dy vendeve.



Operacion i gjerë kërkim-shpëtimi në brigjet jugperëndimore, Forca Ajrore në qendër të ndërhyrjes emergjente

Në kuadër të misionit të saj për siguri dhe reagim emergjent, Forca Ajrore shqiptare është angazhuar në një operacion të gjerë kërkim-shpëtimi, i cili po zhvillohet në brigjet jugperëndimore të vendit. Operacioni po udhëhiqet nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit (RCC Albania), në bashkëpunim të ngushtë ndërinstitucional dhe me mbështetje ndërkombëtare.


Fokusi i operacionit është gjetja e një shtetasi të raportuar si i zhdukur në det nga trageti ndërkombëtar "AKKA". Për realizimin e këtij misioni, Forca Ajrore ka vënë në dispozicion kapacitete ajrore të specializuara:

- 1 dron "Bayraktar" TB2, i pajisur me sensorë të avancuar dhe sistem transmetimi në kohë reale, për mbikëqyrje të zonave detare të përcaktuara.
- 1 helikopter UH-60, me ekuipazh të trajnuar për ndërhyrje në operacione kërkim-shpëtimi në zona bregdetare dhe në det të hapur.

Mjete ajrore janë angazhuar intensivisht në patrullime dhe kërkime në një hapësirë të gjerë detare që shtrihet nga Kepi i Stillos në jug deri te gryka e Semanit në veri. Operacioni po zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Forcën Detare, Policinë Kufitare, si dhe me partnerë ndërkombëtarë italianë nga MRCC Roma, MRSC Bari dhe MRSC Venezia.

Pjesëmarrja e Forcës Ajrore në këtë operacion është një tjetër dëshmi e angazhimit të saj të palëkundur për të garantuar sigurinë dhe shpëtimin e jetëve në rrezik, përmes përdorimit të teknologjisë moderne dhe profesionalizmit të efektivëve të saj.

Operacioni vijon në kushte dinamike, me monitorim të vazhdueshëm dhe reagim të menjëhershëm sipas zhvillimeve në terren dhe kushteve detare.



FA, angazhon dronë dhe helikopterë për kontrollin e zjarreve në terren

Forca Ajrore shqiptare vijon angazhimin intensiv në operacionet për përballimin e vatrave të zjarrit në disa zona të jugut të vendit, përkatësisht në Poliçan, Mallakastër dhe Finiq, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe emergjencave civile.

Në kuadër të këtij operacioni, janë vënë në funksion kapacitetet ajrore për monitorim dhe ndërhyrje, me qëllim parandalimin e përhapjes së flakëve dhe minimizimin e dëmeve në njerëz dhe pasuri natyrore.

- Droni "Bayraktar" TB2 është aktualisht i angazhuar për vëzhgim dhe monitorim në kohë reale, duke ndihmuar në identifikimin e vatrave aktive të zjarrit dhe duke siguruar të dhëna të detajuara për drejtimin e operacioneve në terren.

- Helikopteri "Blackhawk" (UH-60) ka realizuar dhe vijon të kryejë ndërhyrje direkte nga ajri, me hedhje uji mbi zonat e përfshira nga flakët, veçanërisht në ato zona ku aksesimi nga toka është i kufizuar.

Operacionet ajrore kanë një rol vendimtar në koordinimin ndërinstitucional dhe në mbrojtjen e zonave të banuara dhe atyre me rëndësi ekologjike nga përhapja e mëtejshme e flakëve.

Forca Ajrore mbetet në gatishmëri të plotë dhe angazhim të pandërprerë, duke garantuar mbështetje ajrore efektive përballë çdo situatë emergjente, në funksion të sigurisë publike dhe mbrojtjes së territorit kombëtar.

Modernizim Ajror, Rindërtim Detar dhe Prodhim ‘Made in Albania’: Forcat e Armatosura drejt një Epoke të Re Strategjike

Në Bazën Ajrore të Farkës vijon intensivisht puna për Rivlerësimin Strategjik të Mbrojtjes (RSM), një proces kyç i përqendruar në përmbushjen e objektivave të vendosura në Samitin e Hagës, përmes modernizimit, garantimit të vlefshmërisë ajrore sipas standardeve të NATO-s dhe forcimit të kapaciteteve operacionale.

Tre prioritetet strategjike për Forcën Ajrore:

- Modernizimi i flotës ajrore dhe armatimit, duke përfshirë pajisjet teknologjike që nga meteorologjia deri te sistemet moderne të mbrojtjes kundërajrore.
- Zhvillimi i infrastrukturës në bazat ajrore në Gjadër, Rinas, Farkë, Kuçovë dhe Vlorë – me qëllim rritjen e sigurisë, funksionalitetit dhe gatishmërisë për misione ushtarake dhe civile.
- Zhvillimi i burimeve njerëzore, përmes: Rihapjes së Shkollës së Aviacionit në Vlorë; Trajnimit të gjeneratës së re të pilotëve, teknikëve të bordit, kontrollorëve ajrorë dhe operatorëve të sistemeve pa pilot.

Të gjitha këto mbështeten nga investime në infrastrukturë të re, rritje të trajtimit financiar dhe promovim të karrierës ushtarake për të rinjtë shqiptarë. Puna për një Forcë Ajrore moderne dhe efikase po zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me komandat përkatëse, strukturat operacionale dhe partnerët ndërkombëtarë.

Pashaliman: Ringritja e industrisë detare shqiptare

Në Bazën Detare të Pashalimanit, ka nisur vlerësimi teknik me partnerët italianë me



objektivin për ringritjen e kantierit detar, një hap i rëndësishëm drejt prodhimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së anijeve të Forcës Detare.

Krahas kësaj, industria e mbrojtjes shqiptare po tërheq vëmendjen ndërkombëtare. Gjatë 9 muajve të fundit, 20 kompani prodhuese ndërkombëtare kanë shprehur interes për bashkëpunim me KAYO, shoqërinë shtetërore për prodhimin ushtarak “Made in Albania”.

Në qershor dhe korrik 2025, janë finalizuar negociatat me 3 kompani, duke i hapur rrugën krijimit të tri sipërmarrjeve të reja në partneritet publik-privat, për prodhimin e:

- Mjeteve të blinduara dhe të emergjencës civile;
- Uniformave dhe pajisjeve personale;
- Municioneve.

Po ashtu, vijojnë negociatat për prodhimin e armatimit të lehtë, si dhe për asambimin e sistemeve të artilerisë, predhave dhe dronëve


luftarakë. Këto zhvillime shënojnë një etapë të re për mbrojtjen kombëtare shqiptare, ku vizioni strategjik për modernizimin, zhvillimin e kapaciteteve prodhuese vendase dhe integrimin euroatlantik po shndërrohet në realitet.

Rekord aplikimesh në Akademinë e Forcave të Armatosura për vitin 2025-2026: 1634 të rinj synojnë karrierën ushtarake

Akademia e Forcave të Armatosura po tërheq çdo vit e më shumë të rinj dhe të reja të vendosur për t’i shërbyer atdheut me përkushtim, disiplinë dhe ndershmëri. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, bëri të ditur se numri i aplikimeve për programet Bachelor për vitin akademik 2025-2026 ka arritur në 1634, shifra më e lartë e regjistruar ndonjëherë.

“Akademia e Forcave të Armatosura po tërheq çdo vit e më shumë të rinj e të reja, të përkushtuar për t’i shërbyer vendit me dije, disiplinë dhe ndershmëri. 1634 aplikime deri më tani për programet Bachelor për vitin akademik 2025-2026 – shifra më e lartë ndonjëherë! Regjistrimet hapen më 8, 11 dhe 12 gusht, pranë ambienteve të Akademisë së Forcave të Armatosura. Nise sot rrugëtimin tënd drejt së ardhmes”, - deklaroi ministri Vengu. Këto të dhëna tregojnë një interes gjithnjë në rritje të të rinjve për t’u bërë pjesë e strukturave të mbrojtjes dhe për të ndërtuar një karrierë të suksesshme në shërbim të vendit. Akademia ofron një formim të plotë profesional dhe qytetar, duke përgatitur liderët e ardhshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Regjistrimet për programet Bachelor do të zhvillohen më 8, 11 dhe 12 gusht 2025, pranë ambienteve të Akademisë së Forcave të Armatosura.



Kontingjenti Il shqiptar niset drejt Bosnjës dhe Hercegovinës në kuadër të misionit “ALTHEA 2”

Regjimenti i Mbrojtjes me Luftim, Forca Tokësore – Në një ceremoni zyrtare të mbajtur në ambientet e Regjimentit të Mbrojtjes me Luftim të Forcës Tokësore, është përcjellë kontingjenti i dytë shqiptar që do të marrë pjesë në misionin ndërkombëtar “ALTHEA 2” në Bosnje dhe Hercegovinë.

Ceremonia u zhvillua në prani të zëvendëskomandantit të Forcës Tokësore, gjeneral brigade Vehbije Kuti, dhe shefit të Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes, kolonel Blodinel Tafa.

Në fjalën e mbajtur me këtë rast, gjeneral brigade Kuti vlerësoi pjesëmarrjen e vazhdueshme të Forcave të Armatosura në misione ndërkombëtare si një dëshmi e përkushtimit dhe profesionalizmit të ushtarakëve shqiptarë.

“Pjesëmarrja në këtë mision nuk është vetëm një detyrë, por edhe një përgjegjësi. Ju mbartni me vete jo vetëm uniformën që përfaqëson Forcat tona të Armatosura, por edhe vlerat më të larta të vendit tonë: përkushtimin dhe profesionalizmin për të kontribuar në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në rajon e më gjerë”, - theksoi gjeneral Kuti. Ai shtoi se ndonëse të qenët larg familjes është një sfidë, krenaria që ato ndiejnë për këtë përfaqësim e tejkalon çdo



fjalë. Kontingjenti i dytë shqiptar përbëhet nga një togë ushtarake, përfshirë katër vajza, të cilët do të shërbejnë për një periudhë prej rreth gjashtë muajsh në Camp Butmir, Sarajevë. Ky angazhim është vazhdim i kontributit të nisur në shkurt të këtij viti, kur Shqipëria mori pjesë për herë të parë në operacionin “ALTHEA 2”, një mision i Bashkimit Evropian për mbështetjen e paqes dhe sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë.

Ky përfaqësim i radhës tregon për angazhimin serioz të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë kolektive, si dhe për fuqizimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë.

Forca Tokësore përmirëson kapacitetet në përdorimin e UAV-ve në bashkëpunim me Gardën Kombëtare të New Jersey-it

Në kuadër të zbatimit të planit të bashkëpunimit dypalësh mes Gardës Kombëtare të New Jersey-it (GKNJ) dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë, është zhvilluar një trajnim i avancuar me fokus përdorimin e mjeteve ajrore pa pilot (UAV), një komponent kyç në kapacitetet moderne të inteligjencës dhe mbështetjes taktike.

Trajnimi u zhvillua në garnizonet ushtarake të Zall-Herrit dhe Bazës Ajrore të Kuçovës, ku personeli i Forcës Tokësore, konkretisht nga batalioni i këmbësorisë së lehtë (bkl) dhe Regjimenti i Operacioneve Speciale (ROS), u trajnuan nga instruktorë amerikanë të Gardës Kombëtare të New Jersey-it. Pjesëmarrësit u njohën me teknikat më të avancuara të planëzimit operacional dhe kryerjes së detyrave të zbulimit, vëzhgimit dhe zbulimit të objektivave (ISR) përmes sistemeve UAV, tashmë një aftësi shumë e rëndësishme e Forcës Tokësore në fushën e inteligjencës ushtarake. Gjatë trajnimit, efektivat punuan në kushte të ndryshme atmosferike, përfshirë temperatura të larta,

duke simuluar skenarë realë operacionalë për përdorimin e UAV-ve në situata komplekse. Trajnimi përfshiu gjithashtu përgatitjen, realizimin dhe përmbushjen e plotë të procesit operacional, duke prodhuar produkte konkrete informative nga fluturimet dhe misionet e simuluar.

Kjo iniciativë shënon një hap të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura në përdorimin e teknologjive të reja, duke kontribuar në një ndërveprim më të efektshëm dhe të denjë me strukturat homologe të vendeve partnere dhe aleate të NATO-s. Po ashtu, përgatitja e personelit në këto fusha ndikon drejtpërdrejt edhe në përmirësimin e reagimit ndaj emergjencave civile, përmes përdorimit të mjeteve ajrore pa pilot për monitorim dhe menaxhim të situatave kritike.

Niveli i lartë i arritur gjatë këtij trajnimi konfirmon përkushtimin e Forcës Tokësore për të ndërtuar dhe zhvilluar më tej aftësitë moderne në fushën e operacioneve inteligjente dhe të sigurisë kombëtare.



Përfundojnë me sukses Kurset Bazë dhe të Avancuara për Nënoficerë në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse

Në ambientet e Qendrës Stërvitore pranë Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia për përfundimin e Kursit Bazë dhe të Avancuar të Nënoficerit në specialitetet:



Logjistikë/Furnizim, Transport/Mirëmbajtje dhe Armatim/Municion.

Në këtë aktivitet morën pjesë komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, atashëu ushtarak i Republikës së Kosovës, kolonel Enver Hoti, si dhe të ftuar të tjerë nga strukturat ushtarake.

Gjatë kursit, 72 efektivë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Gardës së Republikës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës përvetësuan njohuri të thelluara nëpërmjet programeve teorike, teknike dhe menaxhuese, duke u përgatitur për të përmbushur me sukses detyrat funksionale dhe për të avancuar në karrierën e tyre ushtarake.

Qendra Stërvitore vijon të luajë një rol të rëndësishëm në formimin profesional të personelit ushtarak, jo vetëm brenda Forcave të Armatosura, por edhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar, duke forcuar më tej arsimimin ushtarak dhe koordinimin rajonal në fushën e mbështetjes logjistike dhe operacionale.

FORCAT E
Armatozura



FORCAT E OPERACIONEVE SPECIALE

Misioni që nuk shfaqet, por që vepron

Një ditë brenda jetës dhe stërvitjes së forcës më elitare të Ushtrisë Shqiptare

Në një botë gjithnjë e më të paparashikueshme, siguria kombëtare nuk varet më vetëm nga numrat, por nga cilësia. Brenda strukturës së Forcave të Armatosura të Shqipërisë, ekziston një njësi që vepron në hije, me saktësi, vendosmëri dhe përgatitje maksimale: Forcat e Operacioneve Speciale, të njohura si ROS.

Kjo njësi nuk është vetëm krenari kombëtare. Ajo është një standard profesionalizmi, i ndërtuar mbi disiplinën, sakrificën dhe aftësinë për të përballuar sfida ekstreme. Në këtë numër të gazetës “Ushtria” ju sjellim ekskluzivisht një udhëtim njëditor brenda jetës dhe stërvitjes së kësaj force të veçantë.

Merrezet e para të diellit, fillon heshtja që flet

Zgjimi nuk bëhet nga zhurma e alarmit, por nga ritmi i brendshëm i një trupi të trajnuar për të qenë në gatishmëri. Në këtë njësi, çdo sekondë është e llogaritur. Uniformat janë të pastra, pajisjet në vendin e tyre, mendja e fokusuar.

Stërvitja fizike nuk është thjesht për kondicion. Është për qëndrueshmëri nën presion, për tejkalim të limiteve, për të ndërtuar një trup që nuk dorëzohet kur shpirti sfidohet.

08:00 – Në skenën e betejës së simuluar

Terrenet e stërvitjes janë gjithmonë të ndryshme: nga ndërtesa urbane tek malet e thepisura apo brigjet e egra. Simulimet taktike janë realiste dhe të ndërtuara sipas skenarëve të luftës moderne: infiltrim, goditje precize, çlirim pengjesh, mbulim në kushtet e natës. Çdo operacion i stërvitur është një kombinim i analizës strategjike dhe refleksit të menjëhershëm. Komunikimi është minimal, vendimmarrja është e shpejtë.

12:00 – Kur arma kryesore është mendja

Pas intensitetit fizik, vjen përgatitja psikologjike. ROS, investon në ndërtimin e qëndrueshmërisë mendore, në menaxhimin e stresit të luftës, dhe në ruajtjen e gjakftohësisë në situata kritike.

Sesi merren vendime nën presion, si ruhet qetësia në një operacion të fshehtë apo si trajtohen pasojat emocionale të një misioni, këto janë pjesë të trajnimit të përditshëm që shpesh mbetet i padukshëm për sytë e publikut.

15:00 – Teknologji në shërbim të saktësisë

ROS, nuk operon vetëm me fuqi fizike. Njësia është e pajisur



me teknologji moderne, dronë zbulues, sisteme enkriptimi komunikimi, armë precize, kamera termike, dhe pajisje për ndërhyrje të sofistikuara në mjedise të izoluar.

Ushtarët trajnohen jo vetëm për përdorim, por edhe për mirëmbajtje dhe optimizim të pajisjeve, duke i përshtatur sipas nevojave specifike të çdo operacioni.

19:00 – Reflektim në heshtje

Dita përmbyllet me analizë dhe përgatitje për të nesërmen. Në mbledhjen e mbrëmjes, analizohet çdo lëvizje, çdo vendim, çdo ndërveprim mes pjesëtarëve të skuadrës.

ROS, nuk stërvitet për luftën e sotme, por për atë që mund të ndodhë nesër. Është një njësi gjithmonë në transformim, gjithmonë një hap para.

ROS, fryma që nuk shitet, përkushtimi që nuk hiqet

Në sytë e një pjesëtari të ROS-s nuk do të gjesht as egocentrizëm, as famë. Do të shohësh qartësi, fokus dhe qetësi të ftohtë.

Kjo nuk është një njësi për ata që kërkojnë lavdi, por për ata që janë gati të veprojnë pa zhurmë, kur vendi ka më shumë nevojë se kurrë.

Fakt

28 qershor 1995, me krijimin e Brigadës Komando, sot Batalioni Komando dhe pjesë e Regjimentit të Operacioneve Speciale, u hodhën themelet e një strukture që do të bëhej simbol



i profesionalizmit dhe përkushtimit në shërbim të atdheut.

Që prej vitit 1995, ky repart ka vendosur standarde të larta në stërvitje, operacione të specializuara, mbrojtje të infrastrukturës kritike kombëtare dhe në misione ndërkombëtare.

Angazhimi në operacione në Afganistan, Irak, Çad, Bosnje, Kosovë dhe në zona të tjera të konfliktit, ka konfirmuar gatishmërinë, vendosmërinë dhe nivelin e lartë të përgatitjes që karakterizon Batalionin Komando. Kudo që keni shërbyer, keni përfaqësuar me dinjitet flamurin e Shqipërisë dhe Forcat e Armatosura.

Në një mjedis global me sfida gjithnjë në rritje, përfshirë luftëra afër kufijve të NATO-s, kërcënime kibernetike, terrorizëm transnacional dhe pasiguri rajonale, roli i Batalionit Komando është thelbësor.

Ky repart duhet të qëndrojë në pararojë të çdo reagimi ushtarak, i gatshëm për operacione me rrezik të lartë, ndërhyrje të shpejtë dhe misione të ndërlikuara që kërkojnë fleksibilitet taktik dhe aftësi të avancuara vendimmarrëse.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në kohë PADREJTËSIE, QËNDRIMI ËSHTË AKT HEROIK

Çdo fillim është një ftesë për rilindje

Nuk ka asnjë agim që nuk e paraprin një natë. Nuk ka asnjë shpresë që nuk ka lindur në një moment pasigurie. Ashtu si dielli ngrihet pas terrinës më të errët, edhe shpirti i njeriut ka në thelb dritën që shpërthen pikërisht atëherë kur gjithçka rreth tij duket e fikur.

Ne humanët përballë “humanoidëve” na duhet të shpërfaqim rëndësinë e dritës së brendshme, të asaj force të fshehur në ne, që na mban në këmbë përballë padrejtësive, zhgënjimeve dhe barrëve që na vihen mbi supe, shpesh pa fajin tonë.

Padrejtësia, pesha e pamerituar që rëndon shpirtin

Njeriu shpeshherë përballlet me një realitet të hidhur, të jesh i mirë, i drejtë, i ndershëm, nuk të garanton trajtim të njëjtë nga bota.

Ka raste kur sulmohesh, poshtërohesh, injorohesh, vetëm pse refuzon të bëhesh pjesë e pislëkut, mashtrimit apo urrejtjes kolektive. Kjo barrë e padrejtë është një plagë e heshtur që vret ngadalë, por jo përfundimisht, dhe nëse ti beson tek vetja, kjo barrë bëhet shkallë për të ngjitur veten më lart.

Drita e brendshme, mrekullia që nuk shuhet kurrë

Çdo njeri ka brenda vetes një dritë, një shkëndijë që nuk shuhet kurrë, vetëm mbulohet përkohësisht nga pluhuri i lodhjes, i dhimbjes, i zhgënjimit. Ajo dritë është zëri i shpirtit të lirë, zëri që thërret kur të gjithë të tjerët heshtin. Është fuqia që të ngre kur ke rënë, të mbush me kurajë kur frika të ka kapluar. Dhe sa herë që ia dalim të zgjojmë këtë dritë, përtej plagëve dhe heshtjeve të padrejta, ne jemi duke rilindur.

Forca e brendshme, udhërrëfyesi përmes stuhive

Nuk ka forcë më të madhe se ajo që lind brenda një shpirti që është rrëzuar dhe ka zgjedhur të çohet sërish. Njeriu që nuk dorëzohet, që zgjedh të ngrihet edhe kur gjithçka është kundër tij, është një shembull i fuqishëm i forcës së karakterit. Drita nuk është mungesa e errësirës, por vendimi për të mos u tretur në të. Në një botë ku padrejtësia është shpesh norma, të mbetesh i drejtë është akt trimërie.

Besimi në vetvete, liria më e madhe e ekzistencës

Nëse dikush përpiket të të mposhtë, të shkelë, të ulë vlerën tënde, kujtoje: ti vlen, jo për atë që thonë të tjerët, por për atë që je në thelb!

Vlera e njeriut nuk përcaktohet nga fjalët apo opinionet e të tjerëve, por nga qenia e tij e thellë, nga autenticiteti, ndershmëria dhe dashuria që jep.

Të besosh tek vetja është mënyra më e fortë për t'i thënë botës: “Nuk mund të më mposhtësh”.

Dëshira për të jetuar me kuptim, jo vetëm për të mbijetuar

Nuk mjafton të jetosh, duhet të jetosh me kuptim. Vitet kalojnë, rrethanat ndryshojnë, por ajo që qëndron është ndikimi që kemi në vetvete dhe të tjerët. Jetesa nuk është thjesht një përpjekje për të kaluar ditët, por një mision për të gjetur ndriçimin, për të bërë dritë aty ku ka errësirë. Kjo është rruga drejt përmbushjes së qenies, që tejkalon të gjitha pengesat.

Transformimi i vuajtjes në forcë, një akt i bukurisë njerëzore

Aty ku jeta na ka lënduar më shumë, aty kemi mundësinë të kuptojmë më thellë veten. Plagët janë dëshmi që kemi luftuar, që kemi dashur, që kemi qenë të ndjeshëm. Por, në vend që t'i mbajmë si peshë, le t'i përdorim si urë drejt forcës. Çdo vuajtje është një thirrje për t'u transformuar, për të gjetur kuptim dhe për të mos lejuar që dhimbja të jetë fati ynë i përjetshëm.

Njerëzit e ndriçuar janë ata që i japin kuptim të tjerëve

Kur ti nuk dorëzohesh, ti nuk shpëton vetëm veten. Ti bëhesh shembull, frymëzim, dritë për të tjerët. Sepse drita është ngjitëse, ndriçon edhe shpirtrat që kanë harruar si të shohin. Dritëza jote mund të bëhet diell për dikë tjetër. Ndaj, të mos e nënvlerësojmë kurrë ndikimin që kemi, qoftë edhe përmes një fjale, një gjesti, një akti mirësie.

Ti mundesh! Ti vlen!

Edhe nëse dikush përpiket të të ulë, të të lëndojë, të të injorë, ti ke vlerë. Mos harro kurrë: Ti je dritë, edhe kur rreth teje është errësirë. Ti mundesh të rifillosh çdo herë. Ti vlen, pavarësisht sa herë përpiqen të të thonë të kundërtën. Dhe kur e kupton këtë, atëherë je bërë dritë për veten dhe për botën.

Ilia Kongo – Skënderbegasi që ngriti flamurin e sportit dhe disiplinës shqiptare

NGA: REDAKSIA E GAZETËS “USHTRIA”

Kur vitet kalojnë dhe jeta e një njeriu merr trajtën e reflektimit, shumë kujtime treten, por disa rrënjëzohen fort, duke e formuar përgjithmonë identitetin e tij. Kështu ndodh me Ilia Kongon, ish-nxënës i shkollës ushtarake “Skënderbej”, i cili e konsideron atë periudhë jo vetëm si më të bukurën e jetës, por edhe themelin e karakterit që e përcolli gjatë gjithë rrugëtimit të tij personal dhe profesional.

I lindur, më 20 korrik 1944, në një familje punëtore me origjinë nga Muzina e Delvinës, Ilia Kongo u rrit në zemër të Tiranës, aty ku nisën edhe ëndrrat e tij të para. Ishte një djalosh i gjallë, sportiv dhe i shoqërueshëm, por larg modelit që do të pritej nga një disiplinë ushtarake. Megjithatë, në mënyrë spontane, duke parë me admirim skënderbegasit në rrugët e kryeqytetit, ai mori vendimin që do t’i ndryshonte jetën, të bëhej njëri prej tyre.

Me vendosmëri e pa leje paraprake nga prindërit, aplikoi dhe u pranua në Shkollën Ushtarake “Skënderbej” në vitin 1958. Ky hap i parë i guximshëm u shndërrua në rrugë jetësore për Ilian, që në një mjedis me rregull të hekurt, me togë, hap, këngë dhe zgjime me bori, gjeti kuptimin e vetes dhe zgjoi potencialin e tij të padiskutueshëm.

Sporti si mision dhe afirmim kombëtar

Pikërisht në këtë periudhë fillon të shkëlqejë profili i tij si sportist, nën vëzhgimin e mësuesve të fizkulturës si Bejkush Birçe, Ismet Bellova, Sokol Morina, Pleurat Tahiri, Napolon Tare e të tjerë.

Ishte profesor Birçe, një figurë e shquar e sportit shqiptar, ai që pa tek Ilia potencialin për t’u kthyer në një gjimnast të rangut kombëtar, edhe pse vetë ai nuk kishte ndonjë përvojë të mëparshme në këtë disiplinë.

Përzgjedhja për në ekipin e gjimnastikës, krahas shokëve si Sokrat Pango, Pirro Begvarfi, Hil Gjoni, Isuf Çuni, Divid Ibrahimini e të tjerë, nuk ishte thjesht nder, por një sfidë që kërkonte stërvitje të përditshme, durim dhe përkushtim. Përkundër kushteve të vështira dhe pajisjeve të pakta, ekipi arriti shumë shpejt nivel konkurrues me ekipet më të mira të vendit si ai i Teknikumit të Fizkulturës dhe “17 Nëntorit”.

Në vitin 1959, gjatë Spartakiadës së Parë Kombëtare, Ilia dhe shokët e tij u përfshinë në trekëndëshin e madh gjimnastikor që zhvilloi ushtrime akrobatike në stadium, nën drejtimin e specialistëve të ardhur nga Bashkimi Sovjetik, një përvojë që u ngulit në kujtesën e të gjithëve si ngjarje historike dhe formuese.

Një 16-vjeçar në arenën ndërkombëtare

Më kulmorja e asaj periudhe mbetet përfshirja e Ilia Kongos në ekipin përfaqësues të Shqipërisë në Kampionatin e Gjimnastikës së Ushtrive të Traktatit të Varshavës në vitin 1969, në qytetin Seftenberg të Gjermanisë Lindore. Fillimisht i përjashtuar nga lista, ai u thirr në momentin e fundit dhe për tre javë përjetoi një nga momentet më të rëndësishme dhe mbresëlënëse të jetës.

Vizitat në qytete si Potsdam dhe Drezden, stërvitjet me




FOTO ILUSTRUESE
Skënderbegas ndër vite

trajnerët gjermanë dhe përballja me gjimnastët e vendeve të tjera, e ngritën jo vetëm nivelin e tij fizik, por edhe përvojën jetësore e ndërkombëtare, një eksperiencë e rrallë për një 16-vjeçar.

Respekti që fiton sporti

Në shkollën “Skënderbej”, sportistët ishin të nderuar. Komanda e shkollës me komandantin Luto Haxhiu dhe drejtorin energjik Stavri Angjeli, trupa pedagogjike dhe personeli i shërbimit

i mbështetën me devotshmëri. Ata i krijuan sportistëve kushte sa më të mira për të përfaqësuar denjësisht shkollën dhe vendin.

Në thelb të çdo karriere të suksesshme qëndron një vendim i thjeshtë, një pasion dhe shumë përkushtim.

Ilia Kongo është dëshmia e gjallë e brezit të arit të shkollës ushtarake “Skënderbej”, brez që nuk formoi thjesht ushtarakë, por modelin e qytetarit të përkushtuar, të disiplinuar dhe me shpirt kolektiv.




FOTO ILUSTRUESE
Skënderbegas ndër vite

Veri Talushllari – Një jetë mes uniformës, penës dhe shpirtit atdhetar

Në historinë e brezave që u formuan në bankat e shkollës ushtarake “Skënderbej”, emri i Veri Talushllarit zë një vend të veçantë, jo vetëm për rrugëtimin e tij profesional si oficer, por edhe për shpirtin e tij krijues, përkushtimin ndaj vlerave atdhetare dhe ndjeshmërinë njerëzore që e ka shoqëruar gjatë gjithë jetës.

I lindur, më 27 korrik 1956, në fshatin Zerec të Korçës, Veri Talushllari e nisi rrugën e dijes në Leskovik dhe më pas në Përmet. Rrugëtimi i tij mori trajtë të qartë në vitin 1971, kur, si shumë të rinj të asaj kohe, zgjodhi të hyjë në portat e lavdishme të shkollës “Skënderbej”. Vitet 1971–1975 do të linin gjurmë të pashlyeshme në formimin e tij profesional dhe njerëzor, duke e përgatitur për sfidat e një jete në shërbim të vendit.

Pas një periudhe stazhi në ndërtimin madhor të hidrocentralit të Fierzës, ai ndoqi Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha” në Tiranë, në degën e Artilerisë Kundërajrore. Karriera ushtarake e Veriut do të zhvillohej për një dekadë në



repartet e Pogradecit dhe Korçës, ku, me përkushtim të veçantë, kaloi nga komandant toge në komandant reparti.

Por Veriu nuk ishte thjesht një ushtarak i përkushtuar. Ai ishte edhe një njeri i fjalës. Shumë shkrime të tij, reportazhe e krijime letrare kanë pasur jehonë në shtypin e kohës. Pena e tij, e ushqyer me shpirtin e një skënderbegasi të vërtetë, i dha zë shumë realiteteve të shoqërisë shqiptare, si dhe ndjesive të një brezi që jetonte në kohë të ngarkuara me sfida e sakrifica.

Në vitin 2001, ai u shpërngul familjarisht drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Edhe pse larg Atdheut, ai nuk u nda kurrë nga rrënjët e tij. Përkundrazi, me shpirtin e organizimit dhe ndjenjën e lartë të përgjegjësisë ndaj komunitetit, u bë një ndër nismëtarët dhe mbështetësit kryesorë të Shoqatës së Ushtarakëve Shqiptarë “Skënderbej”, në Nju Jork, një nga organizatat më aktive e më



përfaqësuese të diasporës shqiptare në SHBA.

Jo vetëm kaq, por brenda kësaj shoqate, ai ndihmoi në themelimin e një strukture krejtësisht origjinale, ku ish-oficerët shqiptarë që jetojnë në SHBA mbledhen në festa, përkujtime, ngjarje të jetës, duke ruajtur dhe ringjallur shpirtin atdhetar dhe

lidhjet e paharruara që i bashkuan që nga bankat e shkollës. Aktivitete të cilat Veri i pasqyron dhe në gazetën “Ushtria”, dashurinë e tij të kahershme.

Shpirti që s’ndalet as larg Atdheut

Sot, në Filadelfia, larg maleve të Kolonjës apo oborreve të shkollës “Skënderbej”, Veri nuk ka pushuar së qenë ai që ka qenë gjithmonë: ushtarak i ndershëm, krijues i përkushtuar, njeri që ngroh me fjalë dhe frymëzon me vepra. Në sytë e bashkatdhetarëve të tij, ai mbetet model i atij skënderbegasi që “kurrë nuk e heq uniformën nga shpirti”, edhe pse vitet dhe distanca kanë ndryshuar shumëçka.

Në historinë e vogël të njerëzve të mëdhenj, Veri Talushllari është një emër që meriton të kujtohet për përkushtimin që i dha vendit, për kujtimet që ndan me ne, dhe për atë ndjenjë të pastër që nuk e humbi kurrë: ndjenjën e dashurisë për njeriun, shokun dhe Shqipërinë.

Kanë kaluar pak ditë nga festimi i 69-viteve të jetës së tij, rrugëtim i mbushur me sfida dhe arritje.

Redaksia e gazetës “Ushtria” ju uron nga zemra shëndet të mirë, jetë të gjatë dhe mbarësi në çdo ditë që vjen. Qoftë kjo ditëlindje një tjetër gur themeli në rrugëtimin tuaj të lavdishëm, i mbushur me kujtime krenarie dhe dashurie të ndërsjellë nga të gjithë ata që kanë pasur fatin t’ju njohin.

Gëzuar ditëlindjen, kapiten Veri Talushllari!





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në çdo gur të rrugëve tona të vjetra, në çdo këngë që këndohet nëpër oda, gjurmohet një histori. Jemi një popull që ecën mbi kujtime, që nuk harron, por i mban gjallë me krenari.

Gjurmë në gurët e Kalasë së Krujës, ku zëri i Skënderbeut akoma kumbon në jehonën e maleve, i kujton botës se një popull i vogël mund të mbajë kokën lart përballë fuqive të mëdha. Ato mure të lashta nuk janë thjesht guri, janë dëshmi, janë zëra që flasin edhe sot.

Gjurmë në lahutën e malësorit, që këndon për trimat, për dashuritë e humbura, për tokën që s’njolloset dhe për nderin që nuk shitet. Çdo tel lahute dridhet si një damar që mban gjakun e së kaluarës.

Gjurmë në rrugët e Gjirokastrës, ku kalldrëmi përshkohet nga hija e Ismail Qemalit, Fan Nolit e Migjenit. Nëpër dritaret e shtëpive gurgullojnë tregime të gjyshërve që luftuan për gjuhën, për shkronjat tona të arta, për një komb që nuk pranoi të humbte zërin. Gjurmë në duart e një nëne shqiptare, që punon arat me djersë, por rrit me dinjitet një brez të ri, duke u përcjellë fjalët e urta dhe dashurinë për atdheun.

Gjurmë në diasporë, ku shqiptarët, edhe larg tokës së tyre, e mbajnë gjallë gjuhën dhe traditat.

Në mërgim, një valë flamuri, më 28 Nëntor ka më shumë kuptim se çdo fjalë është gjurmë e një shpirti që nuk shteron kurrë. Gjurmët në kohë nuk janë vetëm kujtime. Janë trashëgimi. Janë lidhja jonë me të shkuarën dhe udhërrëfyes për të ardhmen. Në çdo brez që lind, në çdo fëmijë që mëson të thotë “jam shqiptar”, historia merr frymë përsëri.

Gjurmët e Lavdisë: Kur armët flasin, historia shkruhet

Në çdo betejë të përgjakshme, në çdo uniformë të fyer nga pluhuri i stërvitjeve apo i luftërave, shënohet një gjurmë, jo vetëm në tokë, por në zemrën e kombit.

Ushtria shqiptare ka qenë gjithmonë një mburojë dhe një flamur krenarie për popullin. Nga lufta për pavarësi, tek betejat për çlirim e deri tek roli i saj modern në paqe-ruajtje, ushtari shqiptar ka qenë gjithnjë dëshmi e një shpirti që nuk përkulet.

MBI GJURMË, NDËRTOJMË TË ARDHMEN

Nga trimëria e Skënderbeut tek ushtarët sot

Gjurmë historike:

- Skënderbeu, strateg dhe udhëheqës ushtarak, mbrojti tokat shqiptare për 25 vjet përballë Perandorisë Osmane.
- Lufta Nacionalçlirimtare, me formimin e Brigadave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ku djem e vajza lanë gjithçka për të luftuar për Shqipërinë e lirë.
- Lufta e Kosovës 1998-1999, me përfshirjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i dha kuptim të ri sakrificës shqiptare.

Gjurmët janë në toponimi:

- Qafa e Agronit, Kodra e Martirëve, Lapidari i Brigadës së Parë, etj... nuk janë thjesht emra, por kujtesa të gdhendura në truall.

Vlerat ushtarake dhe disiplina si gjurmë në karakter

- Besnikëri ndaj flamurit: Një ushtar është i pari që qëndron kur të tjerët hezitojnë.
 - Sakrificë: Kur lë familjen për të mbrojtur të gjithë kombin.
 - Formimi moral: Ushtria si shkollë karakteri, ku njeriu kalitet nëpërmjet disiplinës.
 - Trashëgimia brez pas brezi: Kur i biri ndjek rrugën e të atit, dhe uniforma bëhet trashëgimi e gjakut.
- ‘Një ushtar nuk vdes kurrë, ai jeton në kujtimin e popullit të tij’.

Stërvitjet sot, siguria nesër

Gjurmë moderne në Forcat e Armatosura:

- Pjesëmarrja në misione ndërkombëtare: NATO, KFOR.....
 - Modernizimi i pajisjeve dhe teknologjisë.
 - Roli i grave ushtarake: një faqe e re e guximit shqiptar.
 - Akademia e Forcave të Armatosura, vendi ku përgatitet brezi i ri i oficerëve.
- “Teknologjia ndryshon. Zemra e ushtarit shqiptar mbetet e njëjtë, besnike dhe e pathyeshme.”

Mbi gjurmë, ndërtojmë të ardhmen

Nëse shohim prapa, shohim heroizëm. Nëse shohim përpara, shohim detyrë. Gjurmët e ushtarit shqiptar janë të skalitura në çdo brez që e do atdheun më shumë se veten. Kombi jeton kur ushtari i tij ruan paqen, nderin dhe tokën. Ky është mesazhi i gazetës “Ushtria”, një përlulje para të kaluarës, dhe një betim për të ardhmen.



NGA ANIJA
“VLORA” TE
SHPRESAT E
REALIZUARA

Një Rrugëtim
i Shqiptarëve
drejt Lirisë
dhe Integrimit

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Historia e një populli nuk shkruhet vetëm nga datat e mëdha të shpallura me fanfarë, por edhe nga momentet kur dëshpërimi e shpresa përplasen me realitetin. Një nga këto momente për Shqipërinë ishte, më 8 gusht 1991, kur anija tregtare “Vlora” u kthye në një simbol të gjallë të kërimit të lirisë. Mbi 20 mijë shqiptarë u gjendën në bordin e saj, jo për të lundruar, por për të ikur, për të shpëtuar nga rrënojat e një regjimi të rrëzuar, nga uria, izolimi dhe mungesa e të ardhmes. Kjo ngjarje mbetet një nga eksodet më të mëdha dhe më të dhimbshme në historinë e Shqipërisë postkomuniste, dhe shërben sot si një kujtesë e fuqishme kolektive për një kohë të errët që nuk duhet harruar.

Të largohesh nga vendi yt nuk është kurrë një zgjedhje e lehtë. Por në gushtin e nxehtë të vitit 1991, kur Shqipëria sapo kishte dalë nga kthetrat e diktaturës komuniste, mijëra qytetarë zgjedhën të përballeshin me rrezikun e detit përballë rrënimit të jetës së përditshme.

Porti i Durrësit u kthye në një skenë kaotike, ku shqiptarët, të mbushur me ëndrra dhe frikë, hipnin me çdo mjet në anijen “Vlora”, që zakonisht transportonte mallra, por atë ditë transportoi shpresën e një kombi të tërë.

Në orën 19:00, “Vlora” u nis drejt brigjeve italiane, e mbushur përtej çdo kapaciteti, me njerëz që rrinin varur në skaje, në dritare, në çati. Ishte një udhëtim që zgjati një natë, por që për pasagjerët u ndje si një përjetësi, për shkak të mungesës së ujit, ushqimit dhe pasigurisë së plotë për të nesërmen.

Por Italia nuk priti si në mars të po atij viti. Në Bari nuk kishte përgatitje, nuk kishte strehë apo mirëseardhje. Udhëtarët e “Vlora”-s u përplasën me një realitet të ashpër: një stadium i tejmbushur, uri, dhe më pas, kthim mbrapsht. Disa u dërguan në Shqipëri me avionë ushtarakë, me zemrën copë dhe ëndrrat

e vrara. Nga një “anije e shpresës”, “Vlora” u kthye në një dëshmi të fortë të dhimbjes njerëzore dhe të nevojës për dinjitet. Ngjarja e 8 gushtit 1991 është më shumë sesa një episod emigrimi. Është një gur themeli në ndërgjegjen historike të shqiptarëve, një simbol i fuqishëm i një populli që kërkonte lirinë me çdo kusht. Për Italinë, ishte një moment përballje me realitetin e emigracionit masiv. Sot, në portin e Barit, një skulpturë prej metali e cila përkujton atë ditë, si një “urë” mes dy brigjeve, mes dy popujve që u ndanë nga deti, por u bashkuan nga historia. “Vlora” nuk ishte thjesht një anije. Ajo ishte dëshira për të nisur një jetë të re, për të jetuar dhe jo vetëm për të mbijetuar. Dhe kjo dëshirë, pavarësisht kthimit mbrapsht, nuk u shua kurrë. Përkundrazi, ajo i dha formë të ardhmes që shqiptarët nisën të ndërtonin, një jetë në liri.

Pasojat e drejtpërdrejta
dhe fillimi i transformimit

Pas 8 gushtit 1991, emigracioni shqiptar mori përmasa masive dhe të qëndrueshme. Por ajo që e bën këtë periudhë unike është se nuk ishte thjesht një arratisje fizike, ishte një transformim mendor dhe shoqëror. Hapja ndaj botës perëndimore solli përballje me vlera të reja demokratike, me sistemin kapitalist, dhe me mënyra të reja të jetesës. Emigrantët shqiptarë u bënë urë lidhëse mes Shqipërisë dhe Evropës, duke ndikuar në mentalitetin e familjeve që lanë pas dhe duke sjellë kapitale ekonomike, sociale dhe kulturore. Vetëdija kolektive për rëndësinë e lirisë dhe të drejtave njerëzore u rrit ndjeshëm dhe u kthye në një motor ndryshimi.

Arritjet sot: Nga Shpresa në Realitet

Sot, më shumë se tri dekada pas asaj ngjarjeje, shqiptarët kanë arritur përparime të dukshme në disa fusha kyçe si: Integrimi në Evropë dhe Lëvizja e Lirë. Shqipëria ka firmosur marrëveshje të rëndësishme me BE-në dhe ndodhet në rrugën drejt integrimit të plotë. Lëvizja e lirë pa viza (nga 2010) ishte

një moment simbolik që mbylli një cikël historik të izolimit.

Emigracioni si Forcë Ekonomike
dhe Kulturore

Diaspora shqiptare në Itali, Gjermani, SHBA, Zvicër etj., është kthyer në një forcë që kontribuon në zhvillimin ekonomik përmes remitancave, investimeve dhe përvojës së sjellë nga jashtë. Emigrantët janë integruar me sukses, duke arritur nivele të larta të edukimit, pjesëmarrjes politike dhe përfaqësimit në media e sport. Shoqëria Shqiptare: Nga Mbijetesa në Ndërtim Shqipëria ka bërë hapa përpara në ndërtimin e institucioneve demokratike, përkundër sfidave të vazhdueshme. Rinia shqiptare është më e lidhur me botën, më e arsimuar dhe më e ndërgjegjshme për të drejtat e saj.

8 Gushti – Jo Vetëm Kujtim,
por Udhërrëfyes

Sot, skulptura metalike në portin e Barit nuk është vetëm një monument për të përkujtuar të kaluarën. Ajo është një urë simbolike mes së shkuarës dhe së ardhmes, një dëshmi që shqiptarët, përmes sakrificës dhe vendosmërisë, e kanë marrë fatin në duart e tyre. Kjo ngjarje na kujton se: Liria nuk jepet, por fitohet me guxim. Dinjiteti i një populli nuk shuhet kurrë, edhe në kushtet më ekstreme.

E ardhmja ndërtohet me memorie
historike, por edhe me veprim konkret
dhe përkushtim qytetar

Ngjarja e 8 gushtit të vitit 1991 është më shumë se një moment dramatik në historinë shqiptare. Ajo është themeli i një identiteti të ri kombëtar, një identitet që bazohet në kërkimin e lirisë, dinjitetit dhe progresit. Ajo ditë i dha formë rrugëtimit që shqiptarët vazhdojnë edhe sot: nga errësira e izolimit drejt dritës së një të ardhmeje evropiane.

6 Gusht 1945, fillimi i fundit

Në orën 08:15 të mëngjesit të datës 6 gusht 1945, mbi qytetin japonez të Hiroshimës shpërtheu bomba e parë atomike e përdorur ndonjëherë në një konflikt ushtarak. E njohur si “Little Boy”, kjo armë u hodh nga bombarduesi amerikan B29 Enola Gay dhe shpërtheu në lartësinë prej 1,800 metrash mbi tokë.

Me një fuqi shkatërruese ekuivalente me 12.5 kilotonë TNT, bomba rrafshoi rreth 5 milje katrorë të qendrës së qytetit dhe la pas rreth 120,000 të vdekur brenda katër ditëve, shumica civilë. Mijëra të tjerë humbën jetën më vonë si pasojë e plagëve të rënda, djegieve dhe ekspozimit ndaj rrezatimit.

Ndërtesa Promovuese e Industrisë, sot e njohur si Kuba e Bombës Atomike, qëndron ende si dëshmi e asaj dite shkatërruese dhe si simbol i paqes.

9 Gusht 1945, Nagasaki në flakë

Tre ditë më pas, më 9 gusht 1945, një bombë e dytë atomike me nofken “Fat Man” (Burri i Shëndoshë) goditi qytetin e Nagasakit. Megjithëse më e fuqishme, efekti shkatërrues ishte më i kufizuar për shkak të terrenit malor. Rreth 73,000 njerëz humbën jetën dhe 2 milje katrorë të qytetit u bënë shkumb e hi.

Një vendim i vështirë

Hedhja e bombave atomike nuk ishte e rastësishme. Në Konferencën e Potsdamit (korrik 1945), Aleatët i parashtruan Japonisë kërkesën për dorëzim pa kushte, me paralajmërimin se çdo refuzim do të sillte “shkatërrim të menjëhershëm dhe të plotë.”

Ndërkohë, testi i parë bërthamor u realizua më 16 korrik në Alamogordo, New Mexico, duke vërtetuar fuqinë reale të armës. Pavarësisht që Perandori Hirohito sinjalizonte dëshirë për paqe, fraksionet ushtarake brenda qeverisë japoneze refuzonin çdo dorëzim pa kushte.

Operacioni “Rënia” dhe llogaritë e dhimbshme

SHBA kishte planifikuar një pushtim tokësor të Japonisë me emrin “Operacioni Rënia”, që do të niste në nëntor 1945. Vlerësimet e inteligjencës sugjeronin se viktimat në radhët e Aleatëve mund të arrinin në qindra mijëra, deri në miliona.

Në këtë kontekst, përdorimi i bombës atomike shihej si e vetmja rrugë për të përsheptuar fundin e luftës dhe për të shmangur një katastrofë më të madhe humane.



Hiroshima dhe Nagasaki: Fundi i Luftës së Dytë Botërore dhe Agimi i Epokës Bërthamore



Pasojat dhe polemikat

Gjenerali Leslie R. Groves, drejtues i Projektit Manhattan, deklaroi se bombardimet atomike i dhanë fund luftës dhe shmangën viktima edhe më të mëdha, përfshirë ato japoneze.

Megjithatë, përdorimi i armëve bërthamore në qendra civile ka ngjallur polemika të shumta dhe ka lënë plagë të thella morale dhe etike në ndërgjegjen globale. Pamundësia për të “rikthyer shishen” pasi “xhindi” bërthamor u lirua ka qenë thelbësore në formësimin e politikës së frikës bërthamore gjatë gjithë Luftës së Ftohtë dhe më tej.

Koncepti i Shkatërrimit të Sigurt të Ndërsjellë (MAD) lindi në Hiroshima dhe Nagasaki dhe vazhdon të përcaktojë realitetin gjeopolitik të botës moderne.

Përgatiti: Redaksia

Foto historike nga arkivat kombëtare amerikane dhe japoneze



Redaksia e gazetës

Pikëpamjet, opinionet dhe analizat e shprehura në gazetën “Ushtria” janë tërësisht të gazetarëve apo autorëve të materialeve respektive, sjellë pranë redaksisë së kësaj medie dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikën apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.



Mbështetje e re për Ukrainën: 500 milionë dollarë nga Danimarka, Norvegjia dhe Suedia

Danimarka, Norvegjia dhe Suedia konfirmuan se do të financonin një paketë prej 500 milionë dollarësh pajisjesh dhe municionesh për Ukrainën, të furnizuara nga Shtetet e Bashkuara, në kuadër të iniciativës së re të Listës së Kërkesave të Përparësuar të Ukrainës (PURL) të NATO-s. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, përgëzoi Aleatët për veprimin e tyre të shpejtë dhe mbështetjen e palëkundur për Ukrainën.

“Që nga ditët e para të pushtimit në shkallë të plotë të Rusisë, Danimarka, Norvegjia dhe Suedia kanë qenë të palëkundura në mbështetjen e tyre për Ukrainën. I përgëzoj këta aleatë për përpjekjet e tyre të shpejta për ta nisur këtë iniciativë. Ky raund i fundit financimi do të sjellë pajisje shpëtimtare dhe furnizime kritike në vijën e parë të frontit, duke forcuar pozicionin e Ukrainës dhe duke i ndihmuar ata të pengojnë agresionin ndërsa synojnë paqe të qëndrueshme”, tha Sekretari i Përgjithshëm.

Njoftimi pasoi menjëherë zbulimin e paketës së parë të artilerisë dhe municioneve me vlerë më shumë se 500 milionë dollarë të hënën (4 gusht 2025) të financuar nga Holanda. Së bashku, kontributet vlerësohen në mbi 1 miliard dollarë dhe përfaqësojnë dy pjesët e para të dërgesave të rregullta në Ukrainë në kuadër të iniciativës së sapo nisur PURL të Aleancës.

Anëtarët e NATO-s ofrojnë 99% të mbështetjes ushtarake për Ukrainën. Ashtu si me të gjitha përpjekjet e Aleatëve, iniciativa PURL synon ta vendosë Ukrainën në pozicionin më të fortë të mundshëm, ndërsa përpjekjet për paqe, të udhëhequra nga Presidenti Trump dhe administrata e tij, vazhdojnë.

PURL nis me sukses: Holanda financon pajisje amerikane për Ukrainën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, mirëpriti paketën e parë të pajisjeve ushtarake amerikane për Ukrainën, të koordinuar në kuadër të iniciativës së re të Listës së Kërkesave të Përparësuar të Ukrainës (PURL) të NATO-s. Sekretari i Përgjithshëm dhe qeveria holandeze konfirmuan se Holanda po e financon plotësisht paketën e parë.

“E përgëzoj Holandën për marrjen e udhëheqjes dhe shndërrimin e kësaj iniciative në mbështetje konkrete në terren, duke u bazuar në hapat e ndërmarrë javën e kaluar nga Gjermania për të furnizuar më shumë sisteme Patriot në Ukrainë”, tha Sekretari i Përgjithshëm.

“Kjo ka të bëjë me sigurimin e pajisjeve që i nevojiten urgjentisht Ukrainës për t’u mbrojtur kundër agresionit rus. Qëllimi i gjithë ndihmës së Aleatëve për Ukrainën është që lufta të përfundojë drejt një të drejte dhe të qëndrueshme, në mbështetje të përpjekjeve të Presidentit Trump për paqe. U kam shkruar të gjithë Aleatëve të NATO-s, duke i nxitur ata të kontribuojnë në këtë iniciativë për ndarjen e barrës dhe pres njoftime të mëtejshme të rëndësishme nga Aleatët e tjerë së shpejti”, shtoi ai.

Njoftimi i sotëm vjen pas marrëveshjes së bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mark Rutte dhe Presidenti i SHBA-së Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë më 14 korrik 2025. Kjo iniciativë e re financonet nga Aleatët Evropianë dhe Kanadaja dhe do të përbëhet nga paketa të rregullta, secila me vlerë afërsisht 500 milionë dollarë, që përmbajnë pajisje dhe municione të identifikuar nga Ukraina si përparësi operationale. Këto përfshijnë aftësi që Shtetet e Bashkuara mund të ofrojnë në vëllime më të mëdha se vetëm Evropa dhe Kanadaja. Paketat do të përgatiten shpejt dhe do të lëshohen rregullisht. Në Samitin e NATO-s në Hagë, Aleatët ranë dakord që përgjegjësia e përbashkët për të mbështetur Ukrainën duhet të ndahet në mënyrë më të barabartë. “Kjo iniciativë e re përmbush këtë angazhim dhe mbështetet drejtpërdrejt në vendimet kryesore të marra nga udhëheqësit në Hagë duke rritur investimet në mbrojtje dhe duke mbështetur mbështetjen për Ukrainën”, tha Sekretari i Përgjithshëm Rutte.



ANËTARËT E NATO-S OFROJNË 99% TË MBËSHTETJES USHTARAKE PËR UKRAINËN. ASHTU SI ME TË GJITHA PËRPJEKJET E ALEATËVE, INICIATIVA PURL SYNON TA VENDOSË UKRAINËN NË POZICIONIN MË TË FORTË TË MUNDSHËM, NDËRSA PËRPJEKJET PËR PAQE, TË UDHËHEQURA NGA PRESIDENTI TRUMP DHE ADMINISTRATA E TIJ, VAZHDOJNË.

NATO do të koordinojë dorëzimin e paketave, duke përfshirë edhe përmes komandës së Ndhmës dhe Trajnimit të Sigurisë së NATO-s për Ukrainën (NSATU) në Wiesbaden. Duke punuar ngushtë me Ukrainën dhe Shtetet e Bashkuara, Komandanti Suprem i Forcave Aleate për Evropën Alexis Grynkewich do të vërtetojë paketat që korrespondojnë me nevojat e Ukrainës, të tilla si mbrojtja ajrore, municionet dhe pajisjet e tjera kritike për dorëzim të shpejtë nga rezervat e SHBA-së.

PURL plotëson iniciativa të tjera të vazhdueshme për të ofruar mbështetje për Ukrainën, duke përfshirë Fondin e Besimit të Ndhmës dhe Trajnimit të Sigurisë së NATO-s për Ukrainën (NSATU) dhe Pakon e Ndhmës Gjithëpërfshirëse (CAP), si dhe një gamë të gjerë përpjekjesh dypalëshe jetësore nga Aleatët dhe partnerët.

NATO dhe Ukraina: Një Aleancë në Mbështetje të Lirisë

Nga Tirana në Kiev, zëri i solidaritetit euroatlantik nuk ka qenë kurrë më i fortë. Në një kohë kur agresioni rus ndaj Ukrainës ka hyrë në vitin e katërt, NATO ka intensifikuar angazhimet e saj politike, ushtarake dhe financiare për të mbështetur sovranitetin dhe mbrojtjen e vendit të sulmuar.

Angazhimi Strategjik i NATO-s

Mbështetje e pakushtëzuar: Në Samitin e fundit në Hagë, liderët e 32 vendeve anëtare riafirmuan mbështetjen e palëkundur për Ukrainën, duke e cilësuar si një luftë për demokracinë dhe rendin global.

Rruga drejt anëtarësimit: Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, deklaroi se pas fitores, Ukraina do të jetë vendi i 33-të i Aleancës, duke e quajtur rrugën drejt anëtarësimit “të pakthyeshme”.

Ndihma Ushtarake dhe Financiare

40 miliardë euro për vitin 2025: NATO ka premtuar një paketë ndihme ushtarake prej 40 miliardë euro për Ukrainën, e cila përfshin armatime moderne, mbrojtje ajrore dhe pajisje strategjike.

Iniciativa PURL: Vendet si Holanda, Suedia, Norvegjia dhe Danimarka kanë kontribuar me qindra miliona euro për blerjen e armëve amerikane që do t’i dorëzohen Ukrainës përmes mekanizmit të NATO-s “Prioritised Ukraine Requirements List”4. Sisteme Patriot dhe dronë: Paketa përfshin sisteme të mbrojtjes ajrore “Patriot”, municione kundër tankeve dhe pajisje ajrore të avancuara.

Modernizimi i Aleancës

Rritje e buxheteve të mbrojtjes: NATO ka vendosur objektivin ambicioz që vendet anëtare të shpenzojnë deri në 5% të PBB-së për mbrojtje deri në vitin 2035, duke përfshirë ndihmën për Ukrainën si pjesë të këtij angazhimi.

Forca të gatishmërisë së lartë: Aleanca synon të trefishojë kapacitetet ajrore dhe detare, duke përfshirë mbi gjysmë milioni trupa në gatishmëri të lartë. NATO nuk po mbështet vetëm Ukrainën — po mbron parimet e lirisë, sovranitetit dhe rendit ndërkombëtar. Në një epokë ku kërcënimet globale janë më të ndërlikuara se kurrë, Aleanca po tregon se uniteti dhe vendosmëria janë armët më të fuqishme.

Burimi: www.nato.int/

Nga Londra në Prishtinë, nga skenat e Grammy-t te festivalet në zemër të Ballkanit, Dua Lipa ka rrëzuar kufijtë mes artit, aktivizmit dhe identitetit kombëtar. Me një karrierë që ngrihet në maja ndërkombëtare, ajo mbetet e rrënjësuar thellë në origjinën shqiptare, duke e shndërruar veten në simbol të një brezi të ri që nuk harron nga ka ardhur.

Rrënjët shqiptare në zemër të pop-it botëror

E lindur më 22 gusht 1995 në Londër, Dua është bijë e prindërve shqiptarë nga Kosova, Dukagjin dhe Anesa Lipa. Familja e saj u largua nga Prishtina në vitet '90 për shkak të trazirave politike, por nuk e humbi kurrë lidhjen me origjinën.

Në moshë të vogël, Dua jetoi për disa vite në Prishtinë, ku ndoqi shkollën dhe filloi të formësojë pasionin e saj për muzikën. Kjo përvojë la gjurmë të thella dhe ndikon ende sot në stilin, tematikat dhe përkushtimin e saj ndaj kulturës shqiptare.

Karriera muzikore: nga YouTube te Grammy

Hapat e parë i hodhi duke postuar kovera në YouTube në moshën 14-vjeçare, ndërsa guximi dhe zëri i saj unik i hapën dyert e industrisë muzikore. Kontrata me “Warner Music” në vitin 2015 dhe albumi debutues “Dua Lipa” në 2017 e vendosën në radarët globalë.

Këngë si “New Rules”, “IDGAF”, dhe më vonë “Levitating”, “Don’t Start Now”, e “Physical”, jo vetëm që u ngjitën në klasifikimet ndërkombëtare, por edhe u shndërruan në himne të vetëbesimit dhe pavarësisë. Me 3 çmime Grammy, disa BRIT Awards dhe miliona ndjekës, Dua sot është një nga artistet më me influencë në botë.

Por ajo që e dallon nga shumë yje të tjerë është mënyra se si përfaqëson me krenari identitetin e saj shqiptar, duke e ngritur në pedestal kulturën që shpesh ka mbetur nën hije në arenën ndërkombëtare.

Njohja zyrtare nga Kosova dhe Shqipëria - Tre shtetësi, një identitet i pasur

Dua Lipa është një nga të paktat figura publike që mbajnë tre shtetësi: britanike, shqiptare dhe kosovare — një refleksion i rrugëtimit të saj personal dhe profesional, por edhe i lidhjes së saj të thellë me rrënjët kulturore.

Shtetësia britanike: E lindur në Londër më 1995, Dua e ka këtë shtetësi nga lindja. Ajo u rrit në Mbretërinë e Bashkuar dhe aty nisi karrierën muzikore, duke u bërë një nga artistet më të njohura në skenën ndërkombëtare.

Shtetësia shqiptare: Në nëntor 2022, Presidenti i Shqipërisë i dha Duas shtetësinë shqiptare si vlerësim për kontributin e saj në promovimin e kulturës shqiptare në botë. Ajo e pranoi këtë nder me emocion, duke e cilësuar si një moment krenarie për origjinën e saj.

Shtetësia kosovare: Më 1 gusht 2025, gjatë Sunny Hill Festival në Prishtinë, Dua u nderua me shtetësinë kosovare nga Presidentja Vjosa Osmani. Ceremonia u mbajt në një atmosferë festive, ku një kor fëmijësh këndoi këngën “Levitating” dhe Dua performoi në skenë me babain e saj.

Ky kombinim i tre shtetësive nuk është vetëm simbolik, ai përfaqëson një identitet të pasur dhe të ndërlikuar, ku kultura, historia familjare dhe përkushtimi ndaj komunitetit bashkohen në një figurë që i flet botës me zërin e një shqiptareje moderne.

Ligjet e Mbretërisë së Bashkuar, Shqipërisë dhe Kosovës lejojnë mbajtjen e shtetësive të shumëfishta, kështu që Dua i gëzon të gjitha të drejtat ligjore në secilin vend: mund të votojë, të jetojë, të punojë dhe të përfaqësojë zyrtarisht secilin prej tyre në arenën ndërkombëtare.

Në rrjetet sociale, fansat e kanë cilësuar si një “ikonë ndërkombëtare” dhe “qytetare e botës” — një përshkrim që i përshtatet më së miri një artisteje që ka ndërtuar ura mes kulturave dhe ka sjellë dritë mbi një rajon që shpesh ka qenë në hije.

Identiteti i ndërlikuar në një kohë globale

Tre shtetësitë e Dua Lipës shërbejnë si një simbol i jetës së diasporës moderne. Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur, ku individët lëvizin mes kulturave, gjuhëve dhe historive personale, figura si ajo mishërojnë kompleksitetin dhe bukurinë



Dua Lipa, Ylli që sjell Shqipërinë në hartën globale të muzikës



e përkatësisë së shumëfishtë.

Ky identitet i shtresëzuar e lejon Duan: Të ndërtojë ura mes publikut britanik dhe komuniteteve shqiptare; Të ketë një zë më të fuqishëm në arenën ndërkombëtare për të promovuar çështje si barazia kulturore, diversiteti dhe solidariteti global; Të shfaqet jo vetëm si artiste, por edhe si përfaqësuese kulturore, duke e vënë identitetin shqiptar në qendër të vëmendjes botërore.

Në intervista të ndryshme, Dua ka përshkruar identitetin e saj si “të pasur, kompleks dhe formësues për çdo vendim të jetës”. Për shumë të rinj shqiptarë në diasporë, ajo është refleksion i tyre — një frymëzim për ata që ndihen mes dy (apo tre) botëve dhe që kërkojnë të gjejnë vendin e tyre pa u detyruar të zgjedhin vetëm një pjesë të vetes.

Sunny Hill Festival, një urë mes Perëndimit dhe Prishtinës

Në vitin 2018, së bashku me babain e saj, Dukagjin Lipa, Dua themeloi “Sunny Hill Festival” në Prishtinë — një ngjarje që nuk është vetëm muzikore, por edhe sociale dhe kulturore. Festivali ka sjellë në Kosovë emra të njohur si Calvin Harris, Martin Garrix, Miley Cyrus, J Balvin e shumë të tjerë, duke e kthyer Prishtinën



në një pikë kyçe të hartës muzikore europiane.

Por më shumë se kaq, “Sunny Hill” është një përpjekje për të sjellë investim kulturor, optimizëm dhe ndërveprim mes artistëve vendorë dhe të huaj. Përmes “Sunny Hill Foundation”, një fondacion bamirësie, të ardhurat shkojnë për projekte arsimore dhe komunitete në nevojë në Kosovë. Në edicionin e vitit 2025, vetëm një ditë pas marrjes së shtetësisë kosovare, Dua performoi live në Prishtinë, duke përshëndetur publikun me fjalët: “Ky festival është dashuria ime për Prishtinën dhe për ju”.

Më shumë se një yll, një zë për brezat e rinj

Dua Lipa nuk është thjesht një artiste me rekorde globale — ajo është një model për të rinjtë shqiptarë që ëndërrojnë më shumë, që guxojnë të dalin jashtë kufijve dhe të ndriçojnë me individualitetin e tyre. Ajo ka dëshmuar se arti mund të jetë mjet për ndryshim shoqëror, për ringritje të imazhit kombëtar dhe për ndërtim urash mes popujsh.

Në një intervistë për “Vogue”, ajo shprehej: “Unë nuk dua që njerëzit të më shohin thjesht si një këngëtare, por si një njeri që kujdeset për botën dhe për vendin nga vjen”. Dhe pikërisht këtë ka arritur.

Kina investon në fuqi ushtarake, sfidë për rendin ndërkombëtar

Në vitet e fundit, Kina ka shënuar një rritje të jashtëzakonshme në kapacitetet e saj ushtarake, duke e pozicionuar veten si një aktor gjithnjë e më të rëndësishëm në skenën globale të sigurisë. Me një buxhet mbrojtjeje që në vitin 2025 arrin rreth 240 miliardë dollarë, vendi është tashmë shpenzuesi i dytë më i madh ushtarak në botë, pas Shteteve të Bashkuara.

Nga imitues në inovator

Historikisht, pajisjet ushtarake kineze janë parë si kopje të teknologjive sovjetike apo ruse. Por kjo ka ndryshuar rrënjësisht. Sot, kompanitë shtetërore kineze janë ndër prodhuesit më të avancuar të armëve në botë, duke eksportuar dronë, avionë luftarakë dhe sisteme raketore në vende si Egjipti, Nigeria, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe së fundmi, edhe në Iran.

Avioni luftarak J-20, me teknologji stealth, ka fluturuar në mënyrë të padiktueshme në afërsi të radarëve amerikanë, japonezë dhe koreano-jugorë. Ndërkohë, raketat hipersonike dhe sistemet e luftës elektronike po e bëjnë Kinën një fuqi të frikshme në fushën e teknologjisë ushtarake.

Një flotë që dominon detet

Flota detare kineze është tani më e madhja në botë për nga numri i anijeve, duke tejkaluar edhe SHBA-në. Ushtrimi i fundit detar i Kinës pranë brigjeve të Australisë, pa paralajmërim, shkaktoi ndërprerje të fluturimeve në Detin Tasman dhe shqetësim në bazat ushtarake australiane. Kjo tregon jo vetëm kapacitetin, por edhe guximin strategjik të Pekinit për të sfiduar status quo-në globale.

Lufta në epokën e teknologjisë

Kina ka krijuar një Forcë Mbështetëse Strategjike, e cila mbulon luftën kibernetike, elektronike dhe hapësinore. Kjo forcë është pjesë e një vizioni më të gjerë për të dominuar jo vetëm tokën dhe detin, por edhe hapësirën dhe informacionin. Në konfliktin Indo-Pakistanez të qershorit 2025, avionët J-10C të prodhimit kinez u përdorën për të rrëzuar avionë indianë “Rafale”, duke rritur interesin ndërkombëtar për teknologjinë kineze.

Impakt global dhe dilema strategjike

Ndërsa Kina fuqizon arsenalin e saj, rendi global i pas Luftës së Ftohtë po vihet në pikëpyetje. Aleancat tradicionale si NATO po rishikojnë strategjitë e tyre, ndërsa vendet e rajonit Indo-Paqësor po përgatiten për skenarë që dikur dukeshin hipotetikë. Tajvani, për shembull, ka organizuar stërvitjet më të mëdha ushtarake në historinë e tij, në pritje të një përballjeje të mundshme.

Një epokë e re rivaliteti

Në këtë kontekst, fuqia ushtarake e Kinës nuk është thjesht një çështje rajonale, por një faktor kyç në formësimin e rendit të ri botëror. Ajo përfaqëson një sfidë për dominimin perëndimor, një alternativë për vendet që kërkojnë të dalin nga orbita e SHBA-së, dhe një dilemë për ata që përpiqen të ruajnë ekuilibrin global.

Kina po shndërrohet me shpejtësi në një superfuqi ushtarake, duke sfiduar ekuilibrat e vendosur të rendit global. Me një buxhet mbrojtjeje që në vitin 2025 arrin në rreth 240 miliardë dollarë, ajo renditet si shpenzuesja e dytë më e madhe ushtarake në botë, pas Shteteve të Bashkuara.

Forca njerëzore dhe organizimi

Kina ka rreth 975,000 trupa aktive në ushtrinë tokësore, duke e bërë atë forcën më të madhe tokësore në botë.

Ushtria Popullore Çlirimtare (PLA) përfshin pesë degë kryesore: Forcat Tokësore (PLAGF); Forcat Ajrore (PLAAF); Marina (PLAN); Forca Raketore (PLARF); Forca Mbështetëse Strategjike (PLASSF)

Fuqia ajrore

PLA Air Force po evoluon në një forcë të avancuar, me avionë si J-20 që përdorin teknologji stealth.



Kuriozitet rreth disiplinës ushtarake kineze

Kinezët janë të njohur për disiplinën e tyre dhe kjo është arsyeja pse edhe fëmijëve u thuhet të ruajnë disiplinën të rreptë.

Usharët kinezë mbajnë gjilpëra në jakën e uniformës së tyre si një mjet disiplinues për të ruajtur qëndrimin perfekt gjatë paradave dhe stërvitjeve. Gjilpërat janë të vendosura në mënyrë që të drejtohen nga fyti — nëse një ushtar ul kokën, gjilpëra mund ta godasë, duke shkaktuar dhimbje ose lëndim. Kjo metodë ekstreme është pjesë e një kulture ushtarake që vlerëson disiplinën, uniformitetin dhe kontrollin absolut të trupit.

Ky detaj, ndonëse i pazakontë për standardet perëndimore, është simbol i përkushtimit të ushtarëve kinezë ndaj rregullit dhe përfaqësimit të shtetit me dinjitet. Në parakalime zyrtare, ata ecin me hapa të sinkronizuar dhe kokën drejt, duke krijuar një imazh të fuqishëm të rendit dhe autoritetit.



Kina ka investuar në raketa hipersonike, duke ndërtuar një arsenal që është më i avancuari në botë në këtë fushë.

Dominimi detar

Marina kineze është më e madhja në botë për nga numri i anijeve luftarake, duke tejkaluar SHBA-në.

Kina është vetë-mjaftuese në ndërtimin e anijeve luftarake, falë industrisë së saj të fuqishme të mbrojtjes.

Teknologji dhe hapësirë

PLA ka krijuar një forcë të dedikuar për luftën kibernetike, elektronike dhe hapësinore, duke synuar dominimin në të gjitha dimensionet e konfliktit modern.

Kina ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetin e saj për të projektuar fuqi ushtarake globalisht, jo vetëm në Azi.

Impakti gjeopolitik

Kina ka forcuar lidhjet ushtarake me Rusinë, duke mbështetur

indirekt luftën në Ukrainë dhe duke ndarë teknologji me përdorim të dyfishtë.

Tensionet me Tajvanin janë intensifikuar, me stërvitje të mëdha ushtarake pranë ishullit dhe shkelje të vijave ajrore dhe detare.

Vlerësimi global

Sipas indeksit Global Firepower, Kina renditet e treta nga 145 vende për fuqinë ushtarake, me një Power Index prej 0.0788 (ku 0.0000 është perfekt).

Kina është gjithashtu një fuqi e madhe financiare, prodhuese e naftës, gazit natyror dhe qymyrit.

Ky transformim i kapaciteteve ushtarake të Kinës nuk është thjesht një çështje e brendshme. Ai ka pasoja të gjera për sigurinë globale, ekuilibrat rajonale, dhe strategjitë e aleancave ndërkombëtare. Nëse trendi vazhdon, bota mund të përballlet me një rend të ri botëror, ku fuqia ushtarake dhe teknologjike e Kinës do të jetë një faktor përcaktues.

APLIKO NË SHKOLLAT E LARTA USHTARAKE NË GREQI!

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

FTON TË GJITHË TË RINJTË
AMBICIOZË QË ËNDËRROJNË
NJË KARRIERË USHTARAKE
DHE PROFESIONALE TË
APLIKOJNË PËR 7 KUOTA
STUDIMI NË SHKOLLAT E
LARTA USHTARAKE NË GREQI
PËR VITIN AKADEMIK NË VIJIM.

PROGRAMET E OFRUARA:

- Forca Tokësore (Evelpidon) – 1 kuotë
- Forca Detare (SND) – 1 kuotë
- SASS – Shërbimet e Forcave të Armatosura:
- Mjekësi – 2 kuota
- Psikologji – 1 kuotë
- Ekonomi – 1 kuotë
- Drejtësi – 1 kuotë

**AFATI I FUNDIT PËR
DORËZIM TË
DOKUMENTACIONIT:
08 GUSHT 2025**



DOKUMENTACIONI DORËZOHET FIZIKISHT PRANË:

**QENDRËS SË PERSONEL
REKRUTIMIT (QPR)**

Për më shumë informacion dhe dokumentacionin e
nevojshëm, klikoni këtu:

WWW.MOD.GOV.AL/.../31/STUDIME-GREQI-310725.PDF